

Njoftim aplikimi për licencim

Në zbatim të nenit 40, pika 1 e ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike” i ndryshuar; nenit 19, pika 1, germa ”a”, të *Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e Entit Rregullator të Energjisë*, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.06.2016; si dhe nenit 10, pika 8 dhe 9 të *Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike*, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.06.2016, Njoftojmë se shoqëria “GET Solar Solution” shpk ka aplikuar në Entin Rregullator të Energjisë për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik, me kapacitet të instaluar 24 MW, me vendndodhje në Zonën Kadastrale nr. 3164, fshati Rehovë, Njësia Administrative Qendër, Bashkia Kolonjë, Qarku Korçë, për një afat 30-vjeçar.

Në mbledhjen e datës 08.10.2025, Bordi i ERE-s vendosi të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “GET Solar Solution” shpk në këtë veprimtari.

Ftohen palët e interesuara të shprehin opinionet dhe komentet e tyre me shkrim në lidhje me kërkesën për licencim, brenda 30 (tridhjetë) ditëve (nga data 09.10.2025 deri më 07.11.2025) pranë zyrave të ERE-s, në adresën: Bulevardi “Bajram Curri”, Rruga “Viktor Eftimiu”, 1023, Tiranë; ose në postën elektronike, në adresën erealb@ere.gov.al.